[Shqiptarja.com]

E mërkurë 3 Prill 2024 - Përditësimi i fundit 10:51

Kërko

Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajme që do lexuara më 5 minutat e fundit

1 VIDEO/ Tërmeti 7.4 goditi në Tajvan, shikoni reagimet e dhesë së mujit

2 VIDEO/ Ujë i kriminë, pamje mahnitëse nga 3 shtuqi në Kuartit i Bamë. Gati pat të prisur pushues nga e gjithë bota

3 EE. Dënohet për Pamelinën e Asociacionit, mësohen 'të ardhurat evropiane' të Kosovës

4 Tërmet me magnitudë 7.4 goditi në Tajvan, më i fortë ka 25 vite e Sundit! Ndërtesat të shembura dhe njerëz nën rrënoja (VIDEO + FOTO)

5 Incident me homoseksual e 2 prifërj në Shkodër! Ata i fërkonadhë mbrapa 11 vjeçit nxënës! Banat Becit, shoqërohet në policë

Kronikë

VIDEO/ Shpërthim me tritol në një mobilieri në Durrës, xhamat përtokë! Pistë hetimi konflikteti për çështje pronësie, pronari e mohon! 3 të shoqëruar

Një shpërthim me tritol ka ndodhur orët e para të mëngjesit në një mobilieri në Kodër Rrashbull në Durrës. Mësohet se një sasi e vogël lënde plasëse është hedhur në fasadën e dyqanit të "Luart Mobileri" pas mesnate.

I vendosën tritol në mobileri, pronari: Kjo është hera e tretë, s'kam konflikte! Një person i maksuar hodhi lëndën plasëse dhe u largua

HOROSKOPI

Sh.com Lajmi i fundit

Aksidenti në Këlcyrë, Avokati i Popullit: Kambanë alarmi, të forcohen masat e kontrollit kundër emigrimit të paligjshëm

3 Prill, 10:42

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
3 Prill, 09:09 | Përditësimi: 3 Prill, 10:21

Share

A A

DURRËS- Një shpërthim me tritol ka ndodhur orët e para të mëngjesit në një mobileri në Kodër Rrashbull në Durrës. Mësohet se një sasi e vogël lënde plasëse është hedhur në fasadën e dyqanit të "Luart Mobileri" pas mesnate.

Fatmirësisht nga ngjarja nuk ka të lënduar, por vetëm dëme materiale. Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes, ku duken xhamat përtokë që janë thyer për shkak të shpërthimit. Banorët e zonës shprehen se janë trembur nga shpërthimi i fortë.

> *"E dëgjuam në orën 4. Bombë ku e di unë ca ishte. U trembëm", thotë një banore.*

Sh.com
LEXO EDHE:
Pastrohet bregdeti i Durrësit, Rama: Më tepër flukse turistësh këtë sezon veror (Video)

Policia njofton se pistë hetimi është konflikti për çështje pronësie, por nga ana tjetër në një deklaratë për mediat pronari Artan Alla e mohon, duke thënë se nuk ka konflikte me askënd.

> *"Nga veprimet e para hetimore dyshohet se lënda plasëse është hedhur për shkak të një konflikti për motive pronësie", njofton policia.*
>
> *"S'kam konflikti me asnjë njeri në botë, as për prona s'kam konflikt, as borxh si kam kuqi, e kam me leje ndërtimi, me licencë. Rri këtu te dera e dyqanit me serbes, nuk kam konflikt me asnjeri", tha pronari për mediat.*

Biznesi është i pajisur me kamera sigurie dhe pronari tregon se është filmuar momenti kur një person i maskuar hedh lëndën plasëse dhe largohet në këmbë. Artan Alla thotë se kjo është hera e tretë që i kanë vendosur lëndë plasëse në biznesin e tij.

> *"Kjo është hera e tretë që ma hedhin, e kanë hedhur njëherë në nëntor, njëherë para 3-4 javësh dhe sot prapë", thotë ai.*

Policia ende nuk ka identifikuar autorin e ngjarjes, ndërsa hetimet vijojnë. Deri më tani 3 persona janë shoqëruar në polici për t'u marrë në pyetje.

Raportuan për Report Tv e Shqiptarja.com gazetarët Artur Korriku dhe Aldo Mustafa

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:08

I vendosën tritol në mobileri, pronari: Kjo është hera e tretë, s'kam konflikte! Një person i maksuar hodhi lëndën plasëse dhe u largua

Artan Alla, pronari i mobilierisë në Durrës së cilës iu vendos tritol, thotë se nuk ka asnjë konflikt pronësie. Në një prononcim për gazetarët ai thotë se kamerat kanë filmuar një person të maskuar që ka hedhur tritolin dhe më pas është larguar. Ai thotë se është hera e tretë që i vendosin tritol.

> ***Artan Alla:*** *Unë kam dyqanin këtu. Skam konflikti me asnjë njeri në botë, as për prona skam konflikt, as borxh si kam kuqi, e kam me leje ndërtimi, me licencë. Rri këtu te dera e dyqanit me serbes, nuk kam konflikt me asnjeri.*
>
> ***Gazetarja:*** *Policia tha se ju keni deklaruar se keni një konflikt pronësie për një copë toke me një person tjetër?*
>
> ***Artan Alla****: Ja kanë fut kot. Mbase kanë dyshimet e veta. Kamerat kanë kapur një person duke kaluar këtu, duke e hedh lëndën dhe duke ikur. Ka qenë me kapuç me maskë. Kjo është hera e tretë që ma hedhin, e kanë hedhur njëherë në nëntor, njëherë para 3-4 javësh dhe sot prapë.*

Nga ana tjetër, policia në një njoftim të ndarë për mediat, thotë se dyshohet se shkak për vendosjen e lëndës plasëse është bërë një konflikt për çështje pronësie. Por pronari e mohon.

> *"Në orët e para të mëngjesit, në Rrashbull, Durrës, në ambientet e jashtme të mobilierisë në pronësi të shtetasit L. A., 36 vjeç, është hedhur një sasi lënde e dyshuar plasëse. Si pasojë janë shkaktuar vetëm dëme materiale.*
>
> *Nga veprimet e para hetimore dyshohet se lënda plasëse është hedhur për shkak të një konflikti për motive pronësie. Në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës janë shoqëruar 3 shtetas që dyshohet se kanë dijeni për rastin. Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, vijon hetimet për zbardhjen e rastit, identifikimin e kapjen e autorit/ve", njofton policia.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: artan alla Durres shperthim me tritol

Komento

Ndalohet mrpërdërisht ripublikimi i kësaj shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Jeni dakord me ngritjen e komisionit të posaçëm për dezinformimin?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Rrogozhinë, zbulohet tjetër rast i transportit të emigrantëve kundrejt pagesës, arrestohet 24-vjeçari nga Shkodra (EMRI)
3 Prill, 13:28

Vrasja e Pëllumb Metës/ Dy djemtë kërkuan detyrim paraqitjeje, Apeli i lë në burg
2 Prill, 10:23

Në furgon nga Bari në Durrës me 18 ora të shtrenjta, bizhu e medaljonin 'Armand', Antiskifterat arrestojnë shoferin, pasagjerin dhe pronarin e makinës
2 Prill, 10:02

Pamjet/ Punime për Portin e ri Turistik të Durrësit, Rama: Kthehet në hapësirë çlirësore për pushuesit, i jepet fund gangrenës së rëndë mjedisore
1 Prill, 08:55

E sulmoi kur ishte kandidat i Bashës, se ishte 'nën sqetullën e Edi Ramës' Berisha zgjedh Luan Hotin si kryetar të Rithemelimit në Durrës
30 Mars, 22:40

Hap dyert së shpejti, pamje nga shkolla e re 9-vjeçare 'Zyber Sallaku' në Manzë
30 Mars, 21:42

Durrës, vidhnin statuja në parqe arkeologjike, i shisnin në Itali, Mal të Zi e Greqi për 10 - 20 mijë euro! Arrestohen 2 trafikantë, njëri punonte si roje (VIDEO+EMRAT)
30 Mars, 11:41

"Një shtrat plot me të huaj", komedia premierë në Durrës

Aldo Mustafa

29 Mars, 17:27

Durrës/ Drejt përfundimit shkolla 'Jusuf Hoti' në Katund të Ri, Rama ndan pamjet (VIDEO)
29 Mars, 16:14

Vrasja e Pëllumb Metës, ekspertiza konfirmon: Arma e gjetur në pellgun me ujë u përdor për krimin
29 Mars, 11:23

'Durrah City', Qeveria akordon 900 mijë euro për akademinë e futbollit
28 Mars, 11:09

Dhunë pas ndeshjes Kastrioti-Elbasani, tifozi 30-vjeçari godet me bidon plastik policin, kolegët ndërhyjnë dhe e shoqërojnë
27 Mars, 19:11

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje